

Nr 4, Mars / Prill 2008.

### 1. Promovimi i hidroizolimit të tarracës së Kalasë së Gjirokastrës dhe muzeut të ardhshëm “Kronikë në Gur”.

Në fillim të muajit mars GCDO mbështeti prodhimin e një dokumentari mbi trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës nga Televizioni Publik Shqiptar. Dokumentari u transmetua në dy pjesë në orët e mbrëmjes (prime time) dhe i mundësoi GCDO-së të evidentojë, mes të tjerash, domosdoshmërinë që paraqet hidroizolimi i tarracës masive të Kalasë së Gjirokastrës. Përveç se është urgjencë për mbrojtjen e Kalasë hidroizolimi është hap i parë për të krijuar një muze të ri rajonal, përkohësisht të quajtur “Kronikë në gur”, i cili do të shërbente si fokus për numrin në rritje të vizitorëve të qytetit të gurtë dhe të gjithë rajonit.



Qeveria Shqiptare ka shprehur verbalisht angazhimin e saj financiar për kryerjen e hidroizolimit.




Këtë e konfirmoi ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ylli Pango gjatë vizitës së tij në 19 prill në Gjirokastrë, me rastin e përfundimit të restaurimit të Hanit “Zagoria” dhe fillimit të punimeve restauruese në 6 ndërtesa, si dhe në Qafën e Pazarit (financim i siguar nga Qeveria Shqiptare dhe i administruar nga UNESCO). Ndërkohë është realizuar nga GCDO pastrimi i tarracës së kalasë nga mbetjet e një filmi të realizuar vite më parë në këtë ambient.

## 2. Nënshkrimi i marrëveshjeve me Bashkinë e Gjirokastrës dhe Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës - DRMK.

Gjatë muajve mars prill GCDO nënshkroi 2 marrëveshje të rëndësishme partneriteti dhe bashkëpunimi me Bashkinë e Gjirokastrës dhe DRMK-në.

Marrëveshjet kornizojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen nga këta partnerë të rëndësishëm të veprimtarisë që GCDO, së bashku me partnerë të tjerë, pritet të kryejë gjatë vitit në vazhdim. Të tilla janë restaurimet e ndërtesave historike dhe hapjen e një shkolle të restaurimit, një restaurim në zonën e Pazarit karakteristik dhe hapjen e inkubatorit të artizanatit në bashkëpunim me PNUD-in dhe SwissContact-in, zhvillimin e sinjalistikës turistike në qytetin historik, ndriçimin me panele diellore të Galerisë hyrëse në Kalanë e Gjirokastrës, përmirësimin e pamjes së mjediseve të Kalasë.

## 3. Fillon sezoni turistik. ZIT mirëpret dhe informon turistët e huaj dhe shqiptarë.



Më 17 Mars 2008 Zyra për Informim Turistik (projekt i GCDO-së) mbushi plot 1 vit veprimtari. Për vitin 2007 ZIT u ka shërbyer një numri prej 4049 turistësh në Gjirokastrë. Për këtë vit për periudhën *janar – prill* është shënuar një rritje prej 25 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vit të kaluar. Tre gazetarë të huaj, misioni i të cilëve ishte shkrimi i artikujve në gazeta europiane për Gjirokastrën, kanë marrë informacione dhe shërbime në këtë

zyrë. Ndërkohë shërbimi po përmirësohet më tej.


Shërbimi postar është mundësia e re që do t'ju krijohet turistëve në ZIT, si dhe shtimi dhe pasurimi i dokumentacionit ekzistues që u ofrohet vizitorëve me artikuj të tjerë ( fletëpalosje të tjera, libra artistikë të Kadaresë etj). Krijimi dhe vendosja e tre stendave me informacione për Gjirokastrën në Kakavi, Butrint dhe Rinas, si dhe trajnime për guida turistike në qytet, janë ndër aktivitetet kryesore që ZIT ka planifikuar në vazhdim.

#### 4. Rilevimi i Kalasë së Gjirokastrës.



Një grup entuziast arkitektësh të rinj K. Merxhani, K. Dervishi dhe Gj. Caca kryen për herë të parë rilevimin e plotë të Kalasë së Gjirokastrës. U deshën muaj punë për kryerjen e kësaj detyre monumentale e sponsorizuar nga GCDO, por përmes saj u krijua një bazë e shëndoshë, shumë e

dobishme për çdo projekt të ardhshëm konservimi apo që synon përdorimin e mjediseve të mrekullueshme të Kalasë për qëllime turistike.



#### 5. Krijohet shoqata “Miqtë e Monumenteve” – GCDO përkrah një nismë tjetër rinore.



Nxënësit e shkollës së mesme “Asim Zeneli” në bashkëpunim me GCDO krijuan në 18 prill, në Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve shoqatën rinore “Miqtë e Monumenteve”. Kjo shoqatë së bashku me shoqatën e ambientalistëve ndërmorën po atë ditë një aksion

vullnetar pastrimi

tek Tyrbja e Bektashinjve në Kala, një objekt kulturi me potencial turistik.

Aktiviteti vijoi me një demonstrim që GCDO ndërmori në tarracën e Muzeut të Armëve për mënyrat e menaxhimit të bimësisë së dëmshme brenda Kalasë. GCDO ka ndërmarrë dhe mbështetur vazhdimisht nisma që synojnë ndërgjegjësimin e rinisë gjirokastrite për njohjen, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës.





## 6. Përgatitjet për Panairin Kombëtar i Artizanatit.



Një grup pune me përfaqësues nga GCDO, Bashkia Gjirokastrë dhe shoqata Miqësia kanë filluar tashmë punën për organizimin e një Panairi Mbarëkombëtar në Gjirokastrë në datat 27 -29 Shtator 2008. Ky aktivitet tre-ditor është vazhdim i panairit lokal të artizanatit që u zhvillua suksesshëm në datat 28 dhe 29 Shtator 2007. Synimi i tij është krijimi i një tradite panairesh, e cila jo vetëm do të rrisë

vizitorët dhe promovojë vlerat e qytetit, por edhe realizimin gradual në Gjirokastrë të një pazari karakteristik turistik. Panairi do të mbledhë artizanë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Parashikohen edhe ekspozita, konferenca e koncerte.

## 7. Artizanati gjirokastrit merr pjesë në trajnimin për drugdhendjen i zhvilluar në Butrint.

Me ftesë të fondacionit “Butrinti”, GCDO mbështeti pjesëmarrjen e artizanatit gjirokastrit në këtë trajnim 3 – ditor. Trajnimi, synoi të ndihmojë artizanët të zhvillojnë aftësitë e tyre për të prodhuar produkte të përshtatshme për tregun turistik.



## Faleminderit !

*\*Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në [spetrela@gjirokastra.org](mailto:spetrela@gjirokastra.org) ose në cel 06920 78767.*